

VENDIM
Nr.642, datë 24.12.1999

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FONDACIONIT “QENDRAT RAJONALE TË
KËSHILLIMIT BUJQËSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Fondet e parashikuara në koston lokale të projektit “Shërbimi Këshillimor Kombëtar Bujqësor” të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.124, datë 20.1.1997, “Për miratimi, në parim, të projektit “Shërbimi Këshillimor Kombëtar Bujqësor, dhe financimin e tij me grant të qeverisë hollandeze”, dhe specifikuar në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Hollandës, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8323, datë 2.4.1998, të përdoren edhe për mbështetjen financiare të fondacionit “Qendrat Rajonale të Këshillimit Bujqësor”, i cili krijohet për të mbështetur fermerët privatë, nëpërmjet trainimeve dhe këshillave teknike.

2.Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta